



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 723/ 5 prot

Datë 06.05.2022

V E N D I M
K.P.P. 421/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 06.05.2022 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatorët ekonomikë “Zeqiri” SHPK dhe “Murati” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-20498-02-23-2022 me objekt: “Blerje tubo plastike te brinjezuara” me fond limit 4,969,800.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 07.03.2022, nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Fier.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK
Rr. “Nasi Pavllo”, pall.15/1, Shkalla 1, Apartamenti 1, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Fier
Lagjja “11 Janari”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Fier
- Subjekti i Interesuar:** Operatori ekonomik “Murati” SHPK
Bulqize Dibër, Rruga Ish Keshilli i Rrethit Bulqize, Lagjja e re, Banesa 775/1, Shkalla 1, Kati 4, Apartamenti 1
- Operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK
Fier, Lagjja Bishanak, Rruga Skenderbeu, Zona Kadastrale 5532, Banese private , Pasuria nr. 1/1088, Kati I-re
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,

Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.02.2022, është publikuar në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, SPE, procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-20498-02-23-2022 me objekt: “Blerje tubo plastike te brinjezuara” me fond limit 4,969,800.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 07.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Fier.

II.2. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 24.03.2022 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. "M u r a t i" SHPK	4 228 500 lekë	kualifikuar
2. “Ervin Luzi” PF	4 389 000 lekë	skualifikuar

3. “Zeqiri” SHPK	4 448 500 lekë	kualifikuar
4. “Sam-Ars 2016” SHPK	4 476 450 lekë	skualifikuar
5. “Luar Bros” SHPK	4 570 500 lekë	kualifikuar
6. “Hest” SHPK	4 752 150 lekë	skualifikuar

II.3. Në datën 06.04.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit, prej të cilit rezulton fitues operatori ekonomik “Murati” SHPK.

II.4. Në datën 07.04.2022, operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK ka paraqitur ankesë njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të paraqitur nga nga operatorët ekonomikë “Zeqiri” SHPK dhe “Murati” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 723/2 prot., datë 08.04.2022, u publikuan kriteret e kualifikimit, të cilat operatori ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK pretendon, se nuk plotësohen nga operatorët ekonomik “Zeqiri” SHPK dhe “Murati” SHPK.

II.6. Me shkresën nr. 723/3 prot., datë 20.04.2022, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor mbi detyrimin e këtij të fundit për dhënie informacioni KPP-së, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 5/16 prot., datën 15.04.2022, protokolluar me tonën me nr. 723/4 prot., datë 21.04.2022, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor, lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, nuk e ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar “Zeqiri” SHPK dhe “Murati” SHPK, nuk ka dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore dhe në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit paraprak të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Luar Bros” SHPK, për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK, me arsyen se nuk plotëson kriterin:

“2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori për të gjitha mallrat e kerkuara. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori, duhet të provohet edhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar. Secili nga dokumentat duhet të jetë i vlefshëm, nëse është në gjuhë të huaj duhet të jetë i perkthyer në shqip dhe i noterizuar, si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Autorizimi i prodhuesit ose autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, të shoqerohet edhe me certifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent për standardin e prodhimit, për zërat e kerkuar objekt prokurimi. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe nëse është në gjuhë të huaj duhet të jetë e perkthyer në shqip dhe e noterizuar.”
K.P.P vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “kapaciteti teknik”, pika 2.3.2 është parashikuar kriteri si më poshtë:

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori për të gjitha mallrat e kerkuara. Në rast se do të paraqitet Autorizim nga Distributori, duhet të provohet edhe lidhja midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar. Secili nga dokumentat duhet të jetë i vlefshëm, nëse është në gjuhë të huaj duhet të jetë i perkthyer në shqip dhe i noterizuar, si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar si: tel, fax, email, website, etj., kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Autorizimi i prodhuesit ose autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, të shoqerohet edhe me certifikatën e cilësisë ISO 9001:2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent për standardin e prodhimit, për zërat e kerkuar objekt-prokurimi. Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe nëse është në gjuhë të huaj duhet të jetë e perkthyer në shqip dhe e noterizuar.

III.1.2. Nga verifikimi në sistemin elektronik, në përmbushje të këtij kriteri, operatori ekonomik “Zeqiri SHPK” ka paraqitur në sistem dokumentacionin si më poshtë:

- Autorizim prodhuesi i datës 02.03.2022 të lëshuar nga Teqja International në të cilën shprehet qartë lidhja midis prodhuesit dhe operatorit ekonomik “Zeqiri” SHPK.
- Certifikatë ISO 9001:2015 e operatorit ekonomik “Zeqiri” SHPK e cila në fushën e certifikimit e përfshinë objektin e veprimtarisë së procedurës së prokurimit.
- Certifikatë DIN EN ISO 9001:2015 e datës 31.08.2021 e lëshuar nga organi certifikues TUV NORD CERT GmbH për subjektin Teqja International S.A e perkthyer dhe e noterizuar.

III.1.3. Në nenin 77, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se:
“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

.....

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 92 pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.1.4. Në nenin 79 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.”

Ndërsa në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , përcaktohet se:

“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.5. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe

besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.6. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik "Zeqiri" SHPK në përmbushje të kërkesës së autoritetit kontraktor të përcaktuar nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, K.P.P gjykon, se me dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik "Zeqiri" SHPK ka përmbushur kërkesat e autoritetit kontraktor. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Sa më sipër, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik "Zeqiri" SHPK me dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, "kriteret e veçanta të kualifikimit", "kapaciteti teknik", pika 2.3.2.

Sa më lart pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Luar Bros" SHPK, për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik "Zeqiri" SHPK, me arsye se nuk plotëson kriterin: *"Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit ose skedë teknike të prodhuesit ose çdo dokument tjetër teknik të prodhuesit, që përmbajnë të dhëna teknike të ketyre mallrave objekt prokurimi, të cilat duhet të perkojnë me karakteristikat apo specififikimet teknike të kerkuara për mallrat objekt prokurimi. [Nese materiali/et të cilat do të paraqiten për të përmbushur kriterin e mesipër janë në gjuhë të huaj, ato duhet të perkthehen në shqip për pjesën e të dhenave teknike të kerkuara si dhe të noterizuara]."* KPP vëren se,

III.2.1 Në shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit, “kriteret e veçanta të kualifikimit”, “kapaciteti teknik”, pika 2.3.3 është parashikuar kriteri si më poshtë:

“2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit ose skede teknike të prodhuesit ose çdo dokument tjetër teknik të prodhuesit, që përmbajnë të dhëna teknike të ketyre mallrave objekt prokurimi, të cilat duhet të perktojnë me karakteristikat apo specifikimet teknike të kerkuara për mallrat objekt prokurimi. [Nese materiali/et të cilat do të paraqiten për të permbushur kriterin e mesipër janë në gjuhë të huaj, ato duhet të perkthehen në shqip për pjesën e të dhënave teknike të kerkuara si dhe të noterizuara].”

III.2.2. Në nenin 77, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, përcaktohet se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

.....

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

Në nenin 92 pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.3. Në nenin 40 “Kërkesat e veçanta për kontratat e mallrave”, pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar , përcaktohet se:

“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të

përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”

Ndërsa në nenin 40 pika 6 shkronja “b” dhe “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar përcaktohet se: “6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
- b) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.2.4. Nga verifikimi në sistemin elektronik në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK ka paraqitur në sistem dokumentacionin si më poshtë:

- *Katalog nga prodhuesi Teqja International SHA;*
- *Certifikatë e inspektimit 3.1 B-EN 10204 për materialin Tub i brinjëzuar HDPE Ø 110 SN8, me gjatesi 6 ml;*
- *Certifikatë e inspektimit 3.1 B-EN 10204 për materialin Tub i brinjëzuar HDPE Ø 160 SN8, me gjatesi 6 ml;*
- *Certifikatë e inspektimit të tubave 3.1 B-EN 10204 për materialin Tub i brinjëzuar HDPE, Ø 200 SN8, me gjatesi 6 ml;*
- *Certifikatë e inspektimit të tubave 3.1 B-EN 10204 për materialin Tub i brinjëzuar HDPE, Ø 315 SN8, me gjatesi 6 ml;*
- *Certifikatë e inspektimit të tubave 3.1 B-EN 10204 për materialin Tub i brinjëzuar HDPE, Ø 400 SN8, me gjatesi 6 ml.*

III.2.5. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK për mospërmbushjen nga “Zeqiri” SHPK të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, konkretisht duke pretenduar se nuk ka paraqitur katalogun/katalogët për të gjithë zërat objekt-prokurim, lidhet me faktin, se autoriteti kontraktor i ka kërkuar sqarim operatorit ekonomik ankimues në sistemin elektronik duke cituar : “*Në shqyrtim të plotësimin të kriterit 2.3.3 (katalog qe permbajne te dhena teknike te ketyre mallrave objekt prokurimi, te cilat duhet te perkojne me karakteristikat apo specifikimet teknike te kerkuara per mallrat objekt prokurimi), ju keni paraqitur katalogun e prodhuesit TEQJA INTERNATIONAL Sh.a. Rrogozhinë, faqja 23 ,Tuba të brinjëzuar prej HDPE me parete dyfishe për sisteme kanalizimesh të nëndheshme jo në presion ku paraqiten specifikimet teknike:*

1. Tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø 160 mm;

2. Tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø 110 mm;

Pas shqyrtimit vizual të të gjithë katalogëve të këtij prodhuesi të paraqitur nga subjektet e tjerë këto specifikime pasqyroheshin vetëm në katalogun tuaj, ndërsa në kataloget e subjekteve të tjerë të cilët sikurse më lart kishin autorizimin nga i njëjti prodhues TEQJA INTERNATIONAL Sh.a. në katalogët e tyre këto specifikime nuk rezultonin. Për sqarime të nevojshme të shqyrtimit të ofertës tuaj, kërkojmë nga ju të paraqisni kopje origjinale të këtij katalogu të paraqitur në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga ana juaj, në kuadër të vijimit të procesit të shqyrtimit dhe kryerjes së verifikimeve të tjera të nevojshme, dokument i cili duhet të dorëzohet pranë

Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të autoritetit kontraktor Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Fier, brenda orarit zyrtar të punës të datës 16.03.2022.” Për sa më sipër operatori ekonomik ankimues ‘Luar Bros’ SHPK me shkresën e dates 15.03.2022, e cila është protokolluar në Bashkinë Fier me nr. 2209 prto., datë 16.03.2022, i ka kthyer përgjigje autoritetit kontraktor.

III.2.6. Akoma më tej, referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se me datë 18.03.2022, KVO e autoritetit kontraktor i është drejtuar subjektit Teqja International SHA me kërkesën për sqarim, duke evidentuar në të se disa prej pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit (përfshirë këtu edhe operatorin ekonomik “Zeqiri” SHPK), kanë paraqitur katalog nga subjekti Teqja International SHA në të cilin nuk evidentohen zërat e kërkuar në preventiv, përkatësisht zërat: Tubo plastike e brinjëzuar SN8- Ø 160 mm dhe Tubo plastike e brinjëzuar SN8- Ø 110 mm. Po ashtu KVO e autoritetit kontraktor, i ka kërkuar subjektit Teqja International SHA të konfirmojë, nëse ky subjekt i prodhon Tubot plastike të brinjëzuar SN8- Ø 160 mm dhe SN8- Ø 110 mm.

III.2.7. Referuar informacionit të autoriteti kontraktor me datë 21.03.2022 subjekti “Teqja International” SHA, në përgjigje të shkresës së datës 18.03.2022 të KVO të autoritetit kontraktor ka sqaruar se: *“Në përgjigje të kërkesës suaj për sqarim datë 18.03.2022, për procedurën me objekt “Blerje tubo plastike të brinjëzuara” me REF-20498-02-23-2022, si dhe konstatimit të bërë nga ana juaj, ju bëjnë me dije si vijon: Shoqëria “Teqja International Sh.a”, prodhuese e produkteve: tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø -315 mm, tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø -200 mm, tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø -160 mm, tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø -110 mm dhe tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø -400 mm vertetoj se kam leshuar autorizim prodhuesi dhe katalog per te gjitha keto produkte per kompanine Luar Bros ShPK ne bazë te kerkeses të saj. Gjithashtu vertetoj se në baze te kërkesave te operatoreve të tjerë “Murati ShPK”, ' Ervin Luzi P.F”, dhe “Zeqiri ShPK” kam leshuar autorizim prodhuesi dhe katalog per produktet e kerkuara sipas tyre dhe Katalogu eshte dhene i pa azhornuari. Në baze të kerkeses tuaj vërtetoj se vetëm kompania Luar Bros ShPK ka kerkuar ne menyre eksplicite katalogët per te gjitha produktet e kerkuara nga ana juaj, si dhe eshte paraqitur në zyren tone për ta marrë të printuar dhe të vulosur e firmosur.*

Pra, ne cilesinë e administratorit të shoqërise “Teqja international Sh.a”, prodhues i produkteve tuba (SN8 Ø -315 mm, tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø -200 mm, tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø -160 mm, tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø -110 mm dhe tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø -400 mm.)

Rrjedhimisht, marr përsipër të furnizoj kompaninë fituese me produktet e kerkuara sipas katalogu dhe verifikimeve teknike te kerkuara.”

III.2.8. Sa më sipër, lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK për mospërmbushjen nga “Zeqiri” SHPK të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, konkretisht duke pretenduar, se nuk ka paraqitur katalogun/katalogjet për të gjithë zërat objekt-prokurimi, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE, rezulton, se në katalogun e prodhuesit të ngarkuar në SPE nga operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK nuk janë të pasqyruara zërat, Tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø 160 mm dhe Tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø 110 mm, por siç është përmendur edhe më sipër në këtë vendim, Komisioni vëren, se operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK, ka paraqitur Autorizim prodhuesi lëshuar nga subjekti Teqja International SHA, me anë të së cilit kompania prodhuese

autorizon operatorin ekonomik ankimues për të ofertuar produktet e prodhuara prej saj. Gjithashtu, sipas shkresës që subjekti Teqja International SHA i ka dërguar autoritetit kontraktor, ka konfirmuar prodhimin edhe të zërave Tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø 160 mm dhe Tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø 110 mm, si dhe ka marrë përsipër furnizimin e kompanisë fituese me të gjitha produktet e kërkuara sipas katalogut dhe specifikimeve teknike të kërkuara. Akoma më tej, Komisioni vëren, se operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK, ka ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik edhe certifikatën e inspektimit 3.1B –EN 10204 të lëshuar nga prodhuesi Teqja International SHA, ku specifikimet e produkteve Tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø 110 mm dhe Tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø 160 mm të përcaktuara në certifikatat e inspektimit përputhen me specifikimet teknike të autoritetit kontraktor për këto produkte. Referuar nenit 40 pika 6 shkronja “b” dhe “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Komisioni gjykon se, katalogët teknikë, fotografitë, apo përshkrimet, i shërbejnë autoritetit kontraktor që të vërtetojë, se produktet e ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, plotësojnë kërkesat minimale të vendosura në dokumentet e tenderit. Pra, e rëndësishme është, që autoriteti kontraktor të ketë mundësi të informohet me anë të një dokumenti të lëshuar nga prodhuesi mbi specifikimet teknike të produktit të prodhuar nga ky i fundit, pavarësisht se ky dokument mund të jetë katalog, deklaratë, përshkrim apo skedë teknike. Komisioni sjell në vëmendje, se katalogët, skedat teknike etj., përpilohen nga prodhuesit në mënyrë standarde dhe deklarative, dhe përmbajnë ato informacione që prodhuesi i gjykon të nevojshme. Komisioni gjykon, se për sa kohë që përmbajtja e katalogut nuk është në diskrecion të operatorit ekonomik pjesëmarrës, por është në diskrecion total të prodhuesit të produktit, atëherë ofertuesi i cili nuk është prodhues, nuk mund të penalizohet për përmbajtjen e një dokumenti që nuk hartohet nga ky i fundit. Akoma më tej, Komisioni gjykon, se krahas zhvillimit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor është përgjegjës edhe për monitorimin e kontratës gjatë zbatimit të saj. Gjatë fazës të lëvrimit të mallit objekt-prokurimi, autoriteti kontraktor ka mundësinë që të verifikojë, nëse produkti i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, si dhe me ofertën e premtuar nga operatori ekonomik në fazën e zhvillimit të tenderit. Në rastin konkret, lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, se operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK nuk ka paraqitur katalogun/katalogjet për të gjithë zërat objekt-prokurimi, Komisioni gjykon, se dokumenti përshkruar i përpiluar nga prodhuesi Teqja International SHA, certifikatë e inspektimit 3.1B –EN 10204 e lëshuar nga prodhuesi për produktet Tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø 110 mm dhe Tubo plastike e brinjëzuar SN8 Ø 160 mm është e barasvlefshme me katalogun, pasi ky dokument ka karakter deklarativ dhe përshkruar, sikurse do ishte katalogu apo skeda teknike.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Murati” SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi operatori ekonomik “Zeqiri” SHPK përmbush kriteret e kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të KPP do të mbetet e kualifikuar, trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “Murati” SHPK nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto

pretendime do të pranoreshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt-prokurimi, duke qenë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Në këto kushte, KPP gjykon, që pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Luar Bros” SHPK nuk do të merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Luar Bros” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me nr. REF-20498-02-23-2022 me objekt: “Blerje tubo plastike te brinjezuara” me fond limit 4,969,800.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 07.03.2022 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Fier.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Luar Bros”, SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro